



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2018:070705

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05610898

P.nr. 29/2023

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, me gjyqtarin Sabrije Rraci, në çështjen penale kundër të pandehurit P. P nga fsh S, K.K, i akuzuar, për veprë penale Mashtrimi nga neni 335 par 2 të KPRK-se, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/II.nr. 1290/14 të dt. 07.11.2014 e në pajtim me Nenin 253 par. 1 pika 1.3 dhe par. 2 të KPPRK-së, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor me datën 19.04.2023 mori këtë:

AKTVENDIM

- I. HUDHET: aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë PP/II.nr. 1290/14 të dt. 07.11.2014, për të pandehurin: P. P, nga fsh S, K.K.
- II. PUSHOHET: Procedura penale ndaj të pandehurit të theksuar si në pikën 1 të këtij dispozitivit të këtij Aktvendimi, për shkak të parashkrimit Apsolut të ndjekjes penale për veprën penale për të cilën ngarkohet.
- III. SHPENZIMET: procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykatë.
- IV. Udhëzohet pala e dëmtuar Gj. P nga fsh S, K. K, qe kërkesën pasurore juridike ta realizoi në kontest civil.

A r s y e t i m

Në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega ne Klinë, Prokuroria Themelore në Pejë, ka ngrit aktakuzë, kundër të pandehurit, P. P nga fsh S, K.K, i akuzuar, për veprë penale Mashtrimi nga neni 335 par 2 të KPRK-se, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në

Pejë, PP/II.nr. 1290/14 të dt. 07.11.2014 bazuar në shkresat e lëndës sipas Aktakuzës PP/II.nr. 1290/14 të dt. 07.11.2014 vepra penale është kryer me datën 17.04.2014, kurse është pranuar në këtë gjykatë me datën 18.11.2014.

Nga ajo kohë Gjkata i ka ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale, ashtu që edhe sot konstatohet se kanë kaluar më shumë se 10 vite, nga kryerja e kësaj vepre penale, Mashtrimi nga neni 335 par 2 të KPRK-se, kështu që ka arritur Parashkrimi Apsolut i kësaj çështje penale.

Andaj Gjkata e hudh aktakuzen e lartëcekur, me arsyetim se ka skaduar afati i Parashkrimit Apsolut i ndjekjes penale, me çka i pandehurit i lartcekur ka kryer veprën penale Mashtrimi nga neni 335 par 1 të KPRK-se, për të cilën është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim 6 muaj deri në 5 vite.

Me çka rezulton fakti se janë përmbushur kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktvendimi për parashkrimin Apsolut të veprës penale të cituar si më lartë, për të cilën është i ngarkuar i pandehuri, pasi që kanë kaluar me shumë se 10 (dhjete vite) nga kryerja e kësaj vepre penale. Ku në dispozitat ligjore të nenit 106 par 1 pika 4 të Kodit penal të Kosovës përcaktohet se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar më shumë se 10 vite nga kryerja e veprës penale të dënueshme me deri në 5 vjet burgim; lidhur me nenin 107 par 8 të Kodit Penal në të cilat dispozita përcaktohet ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, e që në rastin konkretë vepra ka arritur parashkrimin absolut.

Gjkata nxjerr këtë Aktvendim duke iu referuar dispozitave ligjore të nenit 253 par. 1 pika 1.3 dhe neni 358 pika 1.3 par. 2 të KPPRK-së në të cilat përcaktohet:

“Aktvendimin mbi hudhjen aktakuzës mund ta merr gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues edhe pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor”.

Në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 463 par 1 pika 2 të KPPRK-së pala e dëmtuar udhëzohet në kontest civil më qellim të realizimit të drejtës së tij për kompensim dëmi. Komfor dispozitave ligjore të Nenit 454 par. 1 të KPPRK -së u vendos për shpenzime e procedurës penale. Nga arsyet e theksuara si më lartë, komfor dispozitave ligjore të Nenit 106 par 1, pika 4 të KPRK-së u vendos si në dispozitave të këtij Aktvendimi

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA NË KLINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL

P.nr.29/2023 me dt. 19.04.2024

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë
në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimet, e përmes kësaj gjykate.

Gjyqtarja
Sabrije Rraci